



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Në mbështetje të nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në pajtim me nenin 3 pika 7, nenin 12 dhe 18 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 9 të Rregullores Nr. 01/2017 për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, si dhe në mbështetje të vendimit Nr.01/183/2017 datë 18.07.2017, miratuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, me datën 26.07.2017, Rishpall:

KONKURS

Titulli i vendit të punës: Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë

Numri i referencës: 01/01/ZD-AD

Koeficienti: Fix - 1126.13

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Përfaqëson Akademinë para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare
- Është përgjegjës për menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë
- Merr pjesë në punën e Këshillit Drejtues pa të drejtë vote dhe kryeson Këshillin Programor;
- Siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;
- Propozon projektbudgetin vjetor të Akademisë;
- Propozon programin e punës së Akademisë;
- Propozon Strategjinë, Planin e Punës dhe Programin e trajnimeve;
- Propozon listën e trajnerëve për miratim nga Këshilli Drejtues dhe nga lista cakton trajnuesit për zbatim të programit;
- Menaxhon me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë;
- Propozon Projekt Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Akademisë, Projekt Rregulloren mbi përzgjedhjen e trajnuesve, Projekt Rregulloren e punës së Këshillit Drejtues, dhe Projekt Rregulloren e punës së Këshillit Programor dhe akte tjera nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.
- Përgatit raporte të rregullta vjetore dhe raporte të tjera sipas kërkesës së Këshillit Drejtues;
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore të Akademisë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim

Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësitë fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Kushtet për emërimin e Drejtorit

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
- Të ketë diplomë universitare në fushën e drejtësisë, të vlefshme në Republikën e Kosovës;
- Të ketë të dhënë provimin i jurisprudencës
- Të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal
- Të ketë punuar si gjyqtarë, apo prokurorë për së paku pesë (5) vite, apo të ketë tetë (8) vite përvojë pune, prej të cilave së paku pesë (5) vite përvojë menaxheriale
- Të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas ditës së publikimit.

Data e fundit e aplikimit është 10.08.2017

Paraqitja e kërkesave

Aplikacionet merren në Akademinë e Drejtësisë dhe në web faqe zyrtare në këtë link <https://ad.rks-gov.net/>. Aplikacionet dorëzohen në zyrat e AD-së në këtë adresë Rruga “Muharrem Fejza” p.n, Prishtinë, ose aplikacionin dhe dokumentet të skenuara të dërgohen në email: burimenjerezore.ad@rks-gov.net.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim. Aplikacionet që arrijnë pas afatit apo të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:

- Certifikatën e nënshtetësisë,
- Diplomën universitare në fushën e drejtësisë të vlefshme në Republikën e Kosovës,
- Certifikatën për provimin e dhënë të Jurisprudencës,
- Dëshmi mbi përvojën e punës,
- Certifikatën për të dhënat penale, duke dëshmuar se ai/ajo nuk është dënuar për vepër penale,
- Dokumente e tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës,

Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen. Kandidatët të cilët ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Numrat kontaktues: Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në këtë numër telefoni: 038 200 18 671, prej orës 08:00-16:00, ose në emailin: burimenjerezore.ad@rks-gov.net.